

**PROCESVERBAL**  
**Nga seanca e 30-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime**  
**Mediatike Audio dhe Audiovizuele**  
**të mbajtur me datë 22.9.2023**

**Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë:** Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

**Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /**

**Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.**

**Të pranishëm nga Shërbimi Profesional:** Maja Damevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, mr. Emilja Petreska Kamenjarova, mr. Arben Saiti.

**Të pranishmit e tjerë : /**

Z. Petrushevski e hapi seancën e 30-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave në katin e 2-të.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi si vijon:

**RENDIN E DITËS**

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 7-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 6.9.2023.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 29-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 6.9.2023.
3. Propozim-rregullore për ndryshimin e "Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadroviqe për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio".
4. Propozim-vendim për ndryshim të strukturës së pronësisë të SHTR XHEZ FM nga Shkupi.
5. Propozim-vendim për ndryshim të strukturës së pronësisë të SHTR RADIO RED FM nga Tetova.
6. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë për shkëlqje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV.
7. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP, Veles për shkëlqje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV.
8. Propozim për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Shërbime hidraulike dhe elektrike.

9. Propozim për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtja e sistemit hardver për monitorimin e shërbimeve të radios dhe TV dhe mbikëqyrjes së ORRPKE-së.
10. Të ndryshme .

### **Pika 1**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e propozuar nga seanca e 7-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele e mbajtur me datë 6.9.2023, me tekstin e propozuar.

### **Pika 2**

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e propozuar nga seanca e 29-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele e mbajtur me datë 6.9.2023, me tekstin e propozuar.

### **Pika 3**

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-rregulloren për ndryshimin e Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrore për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio. Ai ka shpjeguar se në pajtim me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese me të cilin janë kontestuar disa dispozita të Rregullores, Këshilli i Agjencisë ka miratuar Projekt-Rregulloren e cila më pas është vënë në diskutim publik për 45 ditë, ndërsa afati për dorëzimin e mendimeve dhe propozimeve skadonte më 29 gusht 2023. Në ndërkohë janë mbajtur dy takime me transmetuesit ku janë diskutuar ndryshimet e propozuara dhe janë shprehur qëndrimet dhe mendimet e një pjese të madhe të transmetuesve lidhur me Projekt-rregulloren. Ndryshimet kryesore në këtë akt nënligjor i referohen faktit se në të ardhmen, pas miratimit të tij në pajtim me Vendimin e Gjykatës Kushtetuese, numri minimal i personave të (angazhuar) punësuar nga transmetuesit do të duhet të jetë në marrëdhënie të rregullt pune, duke përfshirë personat që do të marrin pjesë në procesin e krijimit të programit dhe një ndryshim domethënës është se kryeredaktori dhe redaktori përgjegjës do të duhet të jetë në marrëdhënie të rregullt pune. Është bërë klasifikimi i numrit minimal të punonjësve në stacionet televizive dhe në radio, jo vetëm në bazë të transmetimit të programit në nivel kombëtar, rajonal apo lokal, por edhe në bazë të numrit të popullsisë në zonat e transmetimit, si dhe numri i subjekteve aktive që mund të jenë reklamues potencial (të mundshëm) për transmetuesit. Janë marrë disa vërejtje nga transmetuesit, sugjerimet e tyre se si duhet të duket kjo pjesë e Rregullores dhe janë dorëzuar në Këshill. Shumica e propozimeve janë pranuar, ndërsa për ato që nuk janë pranuar, ka shpjegim pse nuk pranohen. Gjatë hartimit të Rregullores, Agjencia është udhëhequr nga analiza në të cilën janë përpunuar të dhënat për numrin e të punësuarve në marrëdhënie të rregullt pune të paraqitur nga transmetuesit në Agjenci sipas llogarive përfundimtare në Regjistrin Qendror. Kjo Rregullore paraqet një sublimim apo kompromis që do t'u mundësojë transmetuesve që në mënyrë profesionale t'i kryejnë obligimet e tyre që i kanë fituar me lejen e dhënë nga Këshilli. Një pjesë shumë e vogël e transmetuesve në takimet dhe në debatin publik deklaruan se këto kushte janë mjaft rigorozë. Megjithatë, shumica e transmetuesve i plotësojnë kushtet, dhe një pjesë e vogël e

transmetuesve do të jetë e nevojshme të përpiqen për të përmbushur kriteret. Meqenëse këto janë kritere minimale, Agjencia nuk ka mundur të shkojë nën këto numra të cilat i janë dorëzuar Këshillit si Projekt-Rregullor për miratim.

Z. Ajdini tha se siç pritej për këtë dokument ka pasur shumë interes nga palët tani për tani. Agjencia dhe Këshilli u gjendën mes dy ekstremeve, nga njëra anë janë transmetuesit që duan të rrisin numrin e të punësuarve dhe nga ana tjetër transmetuesit që duan të zvogëlojnë numrin e të punësuarve. Mirëpo, nga këtu nuk do të doja të dërgohej mesazh dëshpërues se me këtë Rregullore kushtet janë rigorozë, ndërsa në anën tjetër si triumfalist që me këtë është bërë ndonjë dokument. Sipas tij, është hartuar një Rregullore korrekte, e cila do të realizohet me sukses në praktikë.

Z. Fidanoski u pajtua se është i dukshëm interesimi i mediave për këtë dokument, të cilin Këshilli duhet ta miratojë sot. Numri i propozimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve të pranuar tregon se ata janë të interesuar për këtë çështje. Sipas tij, Agjencia dhe Këshilli i dolën në ndihmë dhe shumica e kërkesave, vërejtjeve dhe sugjerimeve të tyre janë pranuar dhe janë inkorporuar në tekstin e propozuar që sot është në rend dite. Ai beson se propozimi në këtë moment është balancuar mirë dhe paraqet kompromisin më të mirë për detyrimin e zbatimit të Vendimit të Gjykatës Kushtetuese, dëshirat e transmetuesve por edhe detyrimin e Agjencisë si rregullator për përkujdesjen e pluralizmit mediatic dhe natyrisht në atë kontekst edhe niveli i demokracisë lokale në vendin tonë. Ky është mendimi i tij personal, Agjencia dhe Këshilli nuk e kanë funksionin që t'i plotësojnë të gjitha dëshirat e transmetuesve, prandaj ai beson se dokumenti është formuluar mirë dhe do t'i përgjigjet sfidës për kë dhe për çfarë është sjellë. Ai shpjegoi se do të ofrojë një propozim, pra mendon se mund të shkohet me një fleksibilitet më shumë (plus) ndaj transmetuesve në lidhje me nenin 21 të Rregullores, në pikën 4 për televizionet rajonale. Duke lexuar analizën e përgatitur nga Shërbimi, ai është udhëhequr nga reperi i popullatës dhe pranë tij është reperi (standardi) i subjekteve aktive afariste, dhe ka vërejtur se ka një mospërputhje të madhe në mes të rajonit D1, gjegjësisht Shkupi dhe rajoneve të mbetura, përveç të fundit për Stogovën. Ai konsideron se numri prej 7 personash për televizionet rajonale për rajonin e Shkupit është adekuat, por se mund të shkohet edhe me një numër më pak, pra në vend të 6 të punësuarve të ketë 5 të punësuar në regjionet e mbetura pa Stogovën, ku numri 3 sipas tij është absolutisht i justifikuar, sepse numri mbi 600 mijë banorë dhe mbi 27 mijë subjekte afariste është disa herë më i madh në krahasim me të gjitha rajonet e tjera në Veles, Stracin, Turtel, Boskija, Pelister, Mali Vllaj, Popova Shapka. Në atë mënyrë do të ndërmerret një hap tjetër për tu dalë në ndihmë të gjithë atyre transmetuesve që besojnë se ky propozim i tij, kuptohet nëse sigurisht miratohet nga Këshilli, do t'u vijë në ndihmë. Në përgjithësi, ai tha se do të japë mbështetje për dokumentin e propozuar.

Z. Petrushevski tha se e përkrah propozimin e z. Fidanoski dhe mendon se është mjaft mirë që numri i të punësuarve të zvogëlohet nga 6 në 5 në regjionet televizive ku ka popullsi më të vogël përveç Shkupit. Në nivel global, ai beson se dokumenti është i balancuar mirë dhe se përmbush dy detyrat themelore, së pari që vendimi i Gjykatës Kushtetuese përmbushet me hartimin e Rregullores së re dhe kushti i dytë është që shumica e mediave do të jenë të kënaqur dhe do të vazhdojnë të funksionojë sepse beson se edhe këtë e përmbush kjo Rregullore. Ky dhe viti i ardhshëm do të tregojë se sa kanë pasur të drejtë, por mendimi i tij është se mes 90% dhe 100% e transmetuesve nuk do të kenë problem me këtë Rregullore, aq më tepër që pjesa më e madhe e propozimeve të tyre janë pranuar, që do të thotë se ky është Propozim i përbashkët i Rregullores së Agjencisë dhe shumicës së transmetuesve.

Ekstremet që i tha z. Ajdini gjithsesi do të mbeten ekstreme, nuk mund të pranohen sepse nuk janë nga shumica e transmetuesve. Ai deklaroi se do ta përkrah këtë Rregullore me propozimin për korrigjim të z. Fidanoski.

Z. Trajçeovski tha se Rregullorja duhet të botohet në "Gazetën Zyrtare të RMV-së" dhe të përgatitet (Teksti i pastruar) i Rregullores me ndryshimet që tani do të miratohen.

Këshilli i Agjencisë me 5 vota "pro" dhe një abstenim nga z. Jançeski e miratoi Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kushtet minimale, teknike, hapësinore, financiare dhe kuadrovike për marrjen e lejes për transmetim televiziv dhe radio ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.172/2014 dhe nr.76/2015), me ndryshimet e propozuara.

Spektori për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike të përgatisë (Tekst të pastruar) të aktit nënligjor të lartpërmendur.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit Rregulloren e mësipërme ta publikon në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb faqen e Agjencisë.

#### **Pika 4**

Udhëheqësja e Spektorit për Planifikim Strategjik dhe të Drejta e Autorit, mr. Magdalena Davidovska Dovleva sqaroi Propozim - vendimin. për ndryshim të strukturës së pronësisë të SHTR XHEZ FM nga Shkupi. Ajo shpjegoni se personi që aktualisht figuron si pronar i këtij radiostacioni ka ndërruar jetë. Në bazë të Aktvendimit për procedurë trashëgimore, i cili është dorëzuar në shtojcë (bashkëngjitje) të Njoftimit për ndryshim të strukturës së pronësisë, është kërkuar pëlqimi që transmetuesi të jetë trashëgimtar, përkatësisht djali i pronarit të ndjerë, të jetë pronar i transmetuesit. Njoftimi është i plotë dhe i rregullt, pronari i ardhshëm nuk figuron si pronar i shoqërive të tjera tregtare dhe nuk ka asnjë pengesë për të qenë pronar i këtij radiostacioni.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin lejohet ndryshimi i strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive XHEZ FM Ljupço SHPKNJP Shkup, me tekstin e propozuar në vendim.

Me ndryshimet e propozuara të strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive XHEZ FM Ljupço SHPKNJP Shkup nuk krijohet koncentrim i kundërligjshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV, gjegjësisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34,35 paragrafi (2) dhe (38) nga Ligji i njëjtë.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit Vendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

#### **Pika 5**

Udhëheqësja e Spektorit për Planifikim Strategjik dhe të Drejtat e Autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva sqaroi Propozim - vendimin. për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR RADIO RED FM nga Tetova. Ajo shpjegoi se nuk ka asnjë pengesë ligjore për miratimin e ndryshimit të planifikuar. Personi që planifikohet të jetë pronari i ardhshëm i radios nuk figuron si themelues i asnjë Shoqërie Tregtare. Njoftimi është i rregullt dhe i plotë. Në këtë drejtim i është dhënë propozim Këshillit që të marrë vendim që do të lejonte këtë ndryshim.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin lejon ndryshim në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, me tekstin e propozuar në vendim.

Me ndryshimet e propozuara të strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë nuk krijohet koncentrim i kundërligjshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV, gjegjësisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) dhe (38) nga Ligji i njëjtë.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 6**

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për Çështje Programore mr.Emilija Petreska Kamenjarova shpjegoi propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë për shkelje të nenit 64, paragrafi (1) të LSHMAAV. Ajo shpjegoi se shkelja është kryer për shkak se një pjesë e programit të transmetuar nuk është përkthyer në gjuhën maqedonase. Bëhet fjalë për film vizatimor dhe për emisionin "Dnevna soba". Meqënëse kjo është shkelja e parë e kësaj dispozite këtë vit, propozohet që të miratohet masë vërejtje publike me afat prej 10 ditësh për respektimin e Ligjit, e më pas vijon mbikëqyrje kontrolli.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-2998/1 të datës 31.7.2023 dhe njëzëri konstatoi Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë, t'i shqiptoi masë vërejtje publike për shkelje të nenit 64, paragrafi (1) të LSHMAAV, sepse më 6 korrik 2023 në filmat vizatimorë "Tom dhe Xheri" ( Tom and Jerry) pjesët në të cilat ka fjalim janë dhënë burimisht në gjuhën angleze, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase. Po ashtu, në emisionin "Dnevna soba", deklarata e bashkëbiseduesit është transmetuar burimisht (në origjinal) në gjuhën serbe, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Në pajtim me pikën 5 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 të datës 7.11.2022, është udhëzuar që në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e nenit 64, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për Çështje Programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryej mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 7**

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për Çështje Programore mr. Emilija Petreska Kamenjarova shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP Veles për shkelje të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV. Ajo shpjegoi se transmetuesi ka shkelur dispozitën që i referohet programit të krijuar burimor. Nuk ka transmetuar të paktën 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, as edhe të paktën gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase transmetuar në periudhën prej orës 7:00 deri në orën 19:00. Meqenëse kjo është shkelja e parë e kësaj dispozite këtë vit, propozohet që të miratohet masë vërejtje publike me afat prej 20 ditësh për harmonizim me Ligjin, e më pas vijon mbikëqyrje kontrolli.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-3334/1 të datës 1.9.2023 dhe njëzëri konkludoi Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV Zdravkin Angelçe Zdravkin SHPKNJP Veles, që t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të neni 92, paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV sepse më 8 gusht 2023 nuk ka transmetuar të paktën 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase dhe as nuk ka transmetuar së paku gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, transmetuar në periudhën prej orës 07:00 deri në orën 19:00.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, është urdhëruar që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektorit për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Sektorit për Çështje Programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike të kryej mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

## **Pika 8**

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike Cvetanka Mitrevska shpjegoi Propozimin për dhënie miratim për zbatim të procedurë për furnizim publik-shërbim: Shërbime hidraulike dhe elektrike. Ajo ka shpjeguar se furnizimi do të realizohet si furnizim me vlerë të ulët duke respektuar të gjitha dispozitat e Ligjit për furnizime publike. Është paraparë në Planin Vjetor për Furnizime publike të Agjencisë për vitin 2023, ndërsa mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Shërbime hidraulike dhe elektrike.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: shërbime hidraulike dhe elektrike është paraparë dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) nr.05-4766/1 datë 23.12.2022, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023.

#### **Pika 9**

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Juridike dhe Furnizime Publike Cvetanka Mitrevska, shpjegoi propozimin për dhënie miratim për realizimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtje të sistemit hardver për monitorim të shërbimeve televizive dhe radio dhe mbikëqyrje të ORRPKE. Furnizimi është e paraparë në Planin Vjetor për Furnizime publike të Agjencisë për vitin 2023, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele vitin 2023, përkatësisht do të sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për vitin 2024. Sipas shumës së mjeteve, furnizimi do të kryhet si procedurë e hapur e thjeshtuar, që nënkupton se shpallja do të publikohet në Sistemin Elektronik për Furnizime Publike dhe në Gazetën Zyrtare të RMV-së duke respektuar dispozitat e Ligjit për furnizime publike. Kontrata që rezulton do të lidhet për një periudhë dyvjeçare.

Z. Petrushevski tha se nga aspekti teknik e di rëndësinë e këtij furnizimi dhe prandaj duhet të realizohet sepse ky sistem që do të mirëmbahet kushton përafërsisht 800-900 mijë euro.

Këshilli i Agjencisë njëzëri i dha miratim Drejtorit të Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Mirëmbajtje të sistemit hardver për monitorimin e shërbimeve televizive dhe radio dhe mbikëqyrje të ORRPKE-së, për një periudhë 2 (dy) vjeçare.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Mirëmbajtje të sistemit hardver për monitorimin e shërbimeve televizive dhe radio dhe mbikëqyrje të ORRPKE-së, për një periudhë 2 (dy) vjeçare është parashikuar dhe është në pajtim me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) nr.05-4766/1 datë 23.12.2022, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023, përkatësisht do të sigurohen me Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2024.

#### **Pika 10**

##### **Të ndryshme**

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Nr. 02-3506/9**

**09.10.2023**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuele  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

